



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 16.5.2023

Nr: 76

Ora: 18:00

URDHËR

PËR

**VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË TË PROCESIT TË NUMËRIMIT TË TË GJITHA
KUTIVE TË VOTIMIT PËR KËSHILLIN E BASHKISË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 32, nenit 33 shkronjat “a” dhe “ë”, nenit 119, pika 5, nenit 168 dhe 171 pika 5, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 23, datë 24.4.2023, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

URDHËROJ:

1. Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ-të) dhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV-të) të vijojnë procesin e numërimit të kutive të votimit për këshillin e bashkisë në mënyrë të pandërprerë.
2. Veprimet apo mosveprimet e anëtarëve/sekretarit të KZAZ-ve dhe të anëtarëve të GNV-ve, përfshirë ngadalësimin e procesit të numërimit, konsiderohen shkelje e pikës 5, të nenit 119 të Kodit Zgjedhor, dhe përbëjnë shpërdorim detyre në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal dhe materiali kallëzues dërgohet menjëherë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës.
3. Ngarkohen KZAZ-të dhe GNV-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 16.5.2023 Nr. 76
Ora: 18:00



“Për vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit për këshillin e bashkisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”